



## Fjalorth – 100 terma mbi ndryshimet klimatike dhe energjinë e qëndrueshme

*Të nderuar lexues,*

*Në botën e sotme, kuptimi i ndryshimeve klimatike dhe energjisë së qëndrueshme është më i rëndësishëm se kurrë. Ndërsa jemi duke u ndeshur me kompleksitetin e këtyre temave, është thelbësore të kemi një kuptim të qartë të terminologjisë së përdorur në diskutime, raporte dhe mbulimin mediatik.*

*Po ju sjellim sot këtë fjalorth që përfshin 100 terma kyç të lidhura me ndryshimet klimatike dhe energjinë e qëndrueshme. Qëllimi ynë kryesor është t'u ofrojmë gazetarëve, publikut të gjerë, administratës publike dhe të gjitha palëve të tjera të interesuara një burim të vlefshëm që qartëson këto koncepte të rëndësishme.*

*Ky fjalorth është përgatitur me kujdes për të siguruar që çdo term të shpjegohet në mënyrë të qartë, koncize dhe të lehtë për t'u kuptuar. Ne kemi theksuar termat që janë më të rëndësishëm për Planin Lokal të Veprimit të Klimës dhe Energjisë (MECAP) dhe Planin Kombëtar të Klimës dhe Energjisë (NECP), duke ofruar një vështrim mbi gjuhën që përdorim në punën tonë. Përveç kësaj, kemi përfshirë një përzgjedhje më të gjerë termash për të ofruar një kuptim më të plotë të fushës. Në disa raste, kemi paraqitur dhe përkufizim zyrtar në gjuhën shqipe. Kur një përkufizim është marrë nga legjislacioni shqiptar, ai është vendosur si shënim në fund të faqes.*

*Ne ju inkurajojmë të eksploroni këtë fjalorth dhe të njiheni me terminologjinë e ndryshimeve klimatike dhe energjisë së qëndrueshme. Në këtë mënyrë ju do të pajiseni me terminologjinë e duhur për të marrë pjesë në diskutime të kuptimshme, për të kuptuar zhvillimet më të fundit dhe për të marrë vendime të informuara në jetën tuaj profesionale dhe personale.*

*Në fund të fjalorthit, do të gjeni një listë burimesh dhe faqesh interneti që u jemi referuar gjatë përpilimit të këtij dokumenti. Ju ftojme të thelloni më tej njohuritë tuaja duke u njohur me këto materiale.*

*Shpresojmë që ky fjalorth do t'ju shërbejë si një mjet i vlefshëm në udhëtimin tuaj drejt kuptimit dhe adresimit të sfidave të ndryshimeve klimatike dhe promovimit të zgjidhjeve të qëndrueshme të energjisë. Lexim të mbarë!*

*Ekipi i Projektit SEMP*

### SEMP në një vështrim të shkurtër

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë (EE) dhe diversifikimi i prodhimit të energjisë me burime të tjera të energjisë së rinovueshme (ER) janë objektiva strategjike kryesore të Qeverisë Shqiptare. **Projekti i Bashkive me Shfrytëzim Inteligent të Energjisë (SEMP)** mbështet bashkitë shqiptare për të zbatuar politikatat kombëtare të energjisë.

Fokusi i projektit është zhvillimi i **një sistemi të menaxhimit të energjisë** në bashkitë pilot, i frymëzuar nga Çmimi Evropian i Energjisë dhe **forcimi i kapaciteteve institucionale** për zbatimin e politikave kombëtare të energjisë, **planifikimin dhe realizimin sa më mirë të masave infrastrukturore të EE dhe ER.**

SEMP është një projekt i **Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO)** i zbatuar në partneritet me **Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)** dhe **Agjencinë Kombëtare për Efikasitetin e Energjisë (AEE)** që vepron si Njësia Kombëtare e Menaxhimit të Projektit (PMU).



## A

**Adaptimi ndaj Ndryshimeve Klimatike:** Veprime dhe strategji të cilat synojnë të reduktojnë cenueshmërinë dhe të rrisin qëndrueshmërinë e sistemeve natyrore dhe njerëzore në përgjigje të ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Adaptimi mund të marrë forma të ndryshme, si masa proaktive të marra në pritje të ndryshimit ose përgjigje reaktive ndaj ndryshimeve reale. Mund të kryhet nga individë, komunitete ose autoritete publike. Disa shembuj të adaptimit përfshijnë ndërtimin e digave lumore ose bregdetare, zhvendosjen nga zonat bregdetare të prirura për përmytje për shkak të ngritjes së nivelit të detit, ose zëvendësimin e kulturave tradicionale me varietetet që janë më të përshtatshme për ndryshimet e temperaturës dhe kushtet e thatësirës.

**Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor:** Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor është një strategji rritjeje që synon adresimin e ndryshimeve klimatike dhe promovimin e një tranzicioni të gjellbër në rajon. Ajo ndihmon vendet e Ballkanit Perëndimor të harmonizojnë rregulloret e tyre mjedisore me legjislacionin Evropian. E bazuar në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane, Agjenda e Gjellbër u miratua gjatë Samitit të Sofjes për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020. Pesë shtyllat e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor janë: 1) Veprimet për Klimën, përfshirë dekarbonizimin, energjinë dhe lëvizshmërinë; 2) Ekonomia Qarkulluese, duke adresuar në veçanti mbetjet, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efiçent të burimeve; 3) Biodiversiteti, që synon mbrojtjen dhe rikthimin e pasurisë natyrore të rajonit; 3) Luftimin e Ndotjeve së ajrit, ujit dhe tokës; 5) Sistemet Ushqimore të Qëndrueshme dhe Zonat Rurale.

**Aplikacioni i Menaxhimit të EEA (EMT):** Aplikacioni i Menaxhimit të EEA (EMT) është një mjet online për bashkitë pjesëmarrëse për të përpunuar dhe zbatuar katalogun e masave. Ai ndihmon në gjurmimin e zbatimit të nismave për efiçencën e energjisë dhe qëndrueshmërinë. EMT lehtëson përpjekjet dhe mundëson monitorimin e përparimit drejt qëllimeve energjetike.

**Auditimi i Energjisë<sup>1</sup>:** Auditimi i energjisë është një proces sistematik që identifikon, priorizon dhe raporton mundësitë për përmirësimin e efiçencës e energjisë dhe reduktimin e kostove të energjisë në ndërtesa dhe objekte. Ky vlerësim përfshin analizimin se si dhe ku përdoret energjia, si dhe identifikimin e mundësive për përfshirjen e burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE). Përmes inspektimeve, diagnostikimeve, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe raportimit, një auditim energjie ofron informacion të vlefshëm mbi përdorimin e energjisë dhe identifikon mundësitë për përmirësimin e efiçencës. Qëllimi është të ndihmojë në marrjen e vendimeve të informuara dhe ndërmarrjen e veprimeve për të përmirësuar efiçencën e energjisë dhe për të reduktuar konsumin e energjisë.

## B

**Bashkëfinancimi:** Bashkëfinancimi është një marrëveshje financimi ku disa entitete kontribuojnë financiarisht në një projekt, duke ndarë barrën financiare dhe duke reduktuar kostot për secilin pjesëmarrës.

**Bashkëpunimi Ndërbashkiak:** Bashkëpunimi ndërbashkiak i referohet përpjekjeve bashkëpunuese ndërmjet bashkive fqinje. Qëllimi është ndarja e burimeve, njohurive dhe strategjive për efiçencën e energjisë dhe veprimet për klimën. Përmes këtij bashkëpunimi, bashkitë punojnë së bashku për të adresuar sfidat e përbashkëta dhe për të arritur qëllime të përbashkëta në fusha si reduktimi i konsumit

**Biodiversiteti:** Biodiversiteti, shkurt për diversitetin biologjik, i referohet shumëllojshmërisë së organizmave të gjallë, përfshirë njerëzit, brenda një zone specifike. Kur biodiversiteti zvogëlohet ose zhduket, kjo jo vetëm që ndikon në mjedisin natyror, por gjithashtu minon objektivat ekonomike dhe sociale të shoqërive njerëzore. Kjo ndodh sepse njerëzit mbështeten në burimet natyrore për nevoja thelbësore si ushqimi, energjia, lëndët e para, ajri i pastër dhe uji i pastër, të cilat janë të rëndësishme

---

<sup>1</sup> **Auditimi i Energjisë:** Auditimi i Energjisë: 'Auditimi i energjisë' është procedura që ndiqet për të mbledhur të dhënat e nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë të një ndërtese ose një grup ndërtimesh, një objekti dhe/ose të një instalimi industrial, në pronësi ose të menaxhuar nga një ent juridik, publik ose privat, me qëllim identifikimin dhe llogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe theksimin e masave që duhen marrë për të përmirësuar efiçasitetin e energjisë. (Ligji Nr. 124/2015 PËR EFIÇENCËN E ENERJISË (i ndryshuar me ligjin nr. 5/2019, datë 7.2.2019)



për mbajtjen e jetës. Rëndësia e ruajtjes së biodiversitetit, si dhe pasojat e mundshme të mosruajtjes së tij, e kanë bërë atë një çështje ndërkombëtare.

**Bioenergji:** Bioenergji është energjia kimike e ruajtur brenda materialeve organike që mund të konvertohet në burime të përdorshme energjie përmes proceseve të ndryshme biologjike, mekanike ose termokimike. Kjo energji mund të përdoret përmes proceseve të tilla si tretja e ushqimit, proceseve mekanike ose përmes proceseve të bazuara në nxehtësi. Bioenergjia ofron një alternativë të ripërtëritshme dhe të qëndrueshme ndaj burimeve tradicionale të energjisë, pasi përdor materiale organike që mund të ripërtërihen.

**Biomasa<sup>2</sup>:** Biomasa është material organik nga bimët dhe kafshët që mund të përdoret për të prodhuar biokarburante. Ajo shërben si një burim i ripërtëritshëm energjie, duke reduktuar nevojën për lëndë djegëse fosile.

**Biokarburanti<sup>3</sup>:** Biokarburantet janë karburante që rrjedhin drejtpërdrejt ose tërthorazi nga biomasa. Ato prodhohen nga materiale organike dhe shërbejnë si një alternativë ndaj karburanteve konvencionale. Është e rëndësishme të theksohet se bio-karburantet që përdoren për qëllime jo energjetike nuk përfshihen në statistikat e energjisë. Këto përfshijnë drurin për ndërtim ose mobilie, biolubrificantët për motorë dhe biobitumin për sipërfaqet rrugore. Biokarburantet kontribuojnë në uljen e varësisë nga lëndët

**Burimet e Energjisë së Rinovueshme:** Burimet e energjisë së rinovueshme janë burime energjie që rigjenerohen ose rinovohen natyrshëm. Shembuj të tillë përfshijnë energjinë diellore, fuqinë e erës dhe biomasën. Këto burime ofrojnë alternativa të qëndrueshme dhe të pastra ndaj formave konvencionale të energjisë.

**Burimet primare të energjisë:** Burimet primare të energjisë i referohet energjisë që sigurohet nga burimet natyrore si qymyri, nafta e papërpunuar, drita e diellit dhe uranumi, energji e cila nuk ka pësuar asnjë konvertim ose transformim të shkaktuar nga njeriu.

## C

## Ç

**Çmimi Evropian i Energjisë (EEA):** Çmimi Evropian i Energjisë (EEA) është një sistem i menaxhimit të cilësisë dhe çmim që jepet për bashkitë dhe rajonet. Ai ndihmon autoritetet lokale në adoptimin e qasjeve të planifikimit ndërdisiplinor dhe zbatimin e politikave efektive të energjisë dhe klimës. Duke marrë pjesë në EEA, bashkitë dhe rajonet mund të përmirësojnë politikat e tyre të energjisë dhe klimës, të rritin efikasitetin e burimeve dhe të kontribuojnë në një të ardhme më të qëndrueshme.

## D

**Dekarbonizimi:** Dekarbonizimi përfshin reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe rritjen e absorbimit të tyre. Kjo kërkon ndryshime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si prodhimi i energjisë, mënyra se si prodhohen dhe shpërndahen mallrat dhe shërbimet, ndërtimi i ndërtesave dhe menaxhimi i tokave. Për të arritur qëllimet e Marrëveshjes së Parisit dhe për të arritur objektivin prej 1.5°, qeveritë dhe bizneset duhet të reduktojnë emetimet e gazeve serrë në mënyrë të shpejtë deri në vitin 2030. Kjo

---

<sup>2</sup> **Biomasa (ALB):** Biomasa është nën-prodakt i produkteve, mbetjeve dhe mbetjeve të dekompozueshme organike, të marra nga aktiviteti prodhues, që përfshin lëndë bimore dhe shtazore, lëndë pyjore dhe të ngjashme industriale, si dhe fraksionin e mbetjeve industriale organike të dekompozueshme, mbetjeve organike të dekompozueshme rurale dhe urbane. (Ligji Nr. 9876, datë 14.2.2008 - Për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburantit dhe lëndëve të tjera të rinovueshme për transport)

<sup>3</sup> **Biokarburanti:** "Biokarburantet" janë karburante, në formë të lëngshme ose gazore, për transport, të cilat prodhohen nga biomasa. (Ligji Nr. 9876, datë 14.2.2008 - Për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburantit dhe lëndëve të tjera të rinovueshme për transport)



përfshin investimin në infrastrukturë të pastër, energji të rinovueshme, praktika të ekonomisë qarkulluese dhe restaurimin e tokës dhe dherave. Gjithashtu, kërkohet rishikimi i modeleve ekonomike që fokusohen drejt rritjes. Dekarbonizimi është thelbësor për të adresuar ndryshimet klimatike dhe për të krijuar një të ardhme të qëndrueshme.

**Dita e Energjisë së Bashkisë:** Dita e Energjisë së Bashkisë është një aktivitet komunitar i organizuar nga bashkia për të promovuar ndërgjegjësimin për eficientë e energjisë, energjinë e rinovueshme dhe veprimet për klimën. Ajo shërben si një platformë për të angazhuar komunitetin dhe palët e interesuara në diskutime, punëtori dhe aktivitete të lidhura me praktikën e qëndrueshme të energjisë. Kjo ditë ka për qëllim të frymëzojë dhe fuqizojë individët të ndërmarrin veprime drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme ndaj sfidave klimatike.

## E

**Ekonomia Qarkulluese:** Një ekonomi qarkulluese është një sistem që synon të ruajë vlerën e produkteve, materialeve dhe burimeve për sa më gjatë të jetë e mundur, duke minimizuar gjenerimin e mbeturinave. Kjo arrihet përmes praktikave të tilla si ripërdorimi, riparimi, riprodhimi dhe riciklimi i produkteve. Zbatimi i masave të ekonomisë qarkulluese mbështet edhe prioritetet e tjera të rëndësishme të BE-së, si p.sh. rimëkëmbja e gjelbër, zbutja e ndryshimeve klimatike, ruajtja e energjisë, mbrojtja e biodiversitetit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

**Eko-dizajni:** Eko-dizajni është përfshirja e aspekteve mjedisore në dizajnin dhe prodhimin e produkteve që ndikojnë në konsumin e energjisë, me qëllim reduktimin e ndikimit negativ të produktit në mjedis gjatë gjithë ciklit të tij të jetës. Eko-dizajni synon të minimizojë gjurmën mjedisore të produkteve gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre, që nga nxjerrja e lëndëve të para deri te asgjësimi. Objektivat kryesore të eko-dizajnit janë reduktimi i konsumit të energjisë dhe burimeve, minimizimi i mbetjeve dhe ndotjes, dhe promovimi i përdorimit të materialeve miqësore me mjedisin.

**Elektrifikimi i Transportit Publik:** Elektrifikimi i transportit publik i referohet procesit të zëvendësimit të mjeteve të transportit publik që përdorin lëndë djegëse fosile me modele elektrike ose hibride. Ky tranzicion ka për qëllim të reduktojë emetimet dhe të përmirësojë cilësinë e ajrit duke përdorur burime energjie më të pastra dhe më të qëndrueshme për transportin publik.

**Emetimet Bazë:** Emetimet bazë janë emetimet e gazeve serrë (GHG) që priten të ndodhin në një skenar ose situatë të dhënë kur nuk merren masa për t'i reduktuar ato. Ato shërbejnë si pikë fillestare për krahasimin dhe vlerësimin e përpjekjeve dhe strategjive për reduktimin e emetimeve.

**EnerCoach:** EnerCoach është një program kompjuterik i ruajtur në cloud që përdoret për kontabilitetin e energjisë në ndërtesat publike dhe ndriçimin rrugor. Ai ndihmon në monitorimin dhe menaxhimin e konsumit të energjisë, duke mundësuar menaxhim të efektshëm të energjisë dhe kursim të kostove.

**Etiketa e Energjisë:** Etiketa e energjisë klasifikon pajisjet që konsumojnë energji bazuar në eficientë e energjisë, në një shkallë me shkronja dhe ngjyra: pajisjet e klasës A (jeshile) janë ato që konsumojnë më pak energji (më eficiente nga pikëpamja energjetike); pajisjet e klasës G (e kuqe) janë ato që konsumojnë më shumë energji. Etiketimi i energjisë ka një funksion të trefishtë:

- klasifikon pajisjet në një shkallë nga A në G, në varësi të sasisë së energjisë që konsumojnë,
- ndihmon konsumatorët të kursejnë para duke u mundësuar të zgjedhin produkte që konsumojnë më pak energji,
- inkurajon kompanitë të dizajnojnë produkte që konsumojnë më pak energji.

## F

**Financimi për Klimën:** Financimi për klimën i referohet burimeve dhe mjeteve financiare që përdoren për të mbështetur veprimet kundër ndryshimeve klimatike. Ky financim është thelbësor sepse siguron fondet e nevojshme për të kaluar në një ekonomi me karbon të ulët dhe për të zvogëluar ndryshimet klimatike. Financimi për klimën mund të vijë nga burime të ndryshme, si entitete publike ose private, dhe



mund të përdoret për aktivitete si reduktimi i emetimeve dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Fondet shumëpalëshe si Fondi i Klimës së Gjelbër (GCF), Fondi Global për Mjedisin (GEF) dhe Fondi për Përshtatje (AF) janë të disponueshme për shtetet me qëllim aksesimin e financimit për klimën. Këto fonde ofrojnë mbështetje financiare përmes granteve, huave dhe mekanizmave të tjerë.

## G

**Gazrat Serë:** Gazrat serë janë një grup gazesh që kontribuojnë në ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike. Protokollin e Kiotos, një marrëveshje mjedisore e miratuar nga shumë prej palëve të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në vitin 1997, synon të reduktojë ngrohjen globale dhe mbulon shtatë gazra serë: dioksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>), metani (CH<sub>4</sub>), oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O), hidrofluorokarbonet (HFCs), perfluorokarbonet (PFCs), heksafluoruri i squfurit (SF<sub>6</sub>) dhe trifluoruri i azotit (NF<sub>3</sub>). Konvertimi i këtyre në ekuivalente të dioksidit të karbonit lejon një krahasim dhe kuptim më të lehtë të ndikimit të tyre individualisht dhe të kombinuar në ngrohjen globale.

## H

**Humbjet dhe Dëmtimet:** Humbjet dhe dëmtimet, në kontekstin e ndryshimeve klimatike, i referohet ndikimeve që ndodhin pavarësisht përpjekjeve për të zbutur dhe përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike. Ky koncept pranon që ka disa kufij gjatë adaptimit dhe që disa efekte të ndryshimeve klimatike janë të pashmangshme. Humbjet dhe dëmtimet mund të përfshijnë pasoja ekonomike dhe jo-ekonomike. Humbjet dhe dëmtimet ekonomike mund të përfshijnë kostot e lidhura me rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar nga dukuri të lidhura me klimën ose erozionin / humbjen e tokës për shkak të rritjes së nivelit të detit. Humbjet dhe dëmtimet jo-ekonomike përfshijnë ndikime të patjetërsueshme, si trauma nga fatkeqësitë natyrore, humbja e jetës, zhvendosja e komuniteteve, humbjet kulturore dhe historike, dhe rënia e biodiversitetit.

## I

**Incentivat e PV:** Incentivizimi i PV në çati dhe tarraca i referohet politikave dhe programeve që synojnë të inkurajojnë instalimin e sistemeve fotovoltaike (PV) diellore në çati dhe në tarraca. Këto nisma ofrojnë stimuj financiarë ose mbështetje rregulatore për ta bërë energjinë diellore më tërheqëse dhe të aksesueshme për individët dhe bizneset.

**Incentivat Tatimore për Ndërtimet e Reja:** Incentivat tatimore për ndërtimet e reja eficiente janë stimuj financiarë, si zbritjet në taksat e pronës, të ofruara për të inkurajuar zhvillimin e ndërtesave që plotësojnë standarde të larta të efikasitetit të energjisë përtej standardeve minimale. Këto incentiva synojnë të promovojnë praktikën e ndërtimit të qëndrueshëm, të reduktojnë konsumin e energjisë dhe të ulin emetimet e gazeve serrë.

**Iniciativa e Qytetarëve:** Për të përmirësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset demokratike të Bashkimit Evropian (BE), Neni 11 i Traktatit mbi Bashkimin Evropian i jep qytetarëve të drejtën e iniciativës. Neni 24 i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian siguron kuadrin për një rregullore të BE-së që përcakton kushtet praktike dhe procedurat për iniciativën e qytetarëve Evropianë (ECI). Kjo mundëson qytetarët të kërkojnë nga Komisioni Evropian të propozojë legjislacion mbi çdo çështje brenda juridiksionit të tij. Kjo iniciativë fuqizon qytetarët të ndikojnë drejtpërdrejt në agjendën legjislative të BE-së dhe promovon një angazhim më të madh demokratik.

**Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN):** Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN) janë organizata të krijuara nga disa kombe për të ofruar ndihmë financiare. Ato ndjekin ligjet ndërkombëtare në vend të ligjeve të një vendi specifik. Zakonisht, IFN-të zotërohen nga qeveritë kombëtare të vendeve të përfshira në krijimin e tyre. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit ekonomik global dhe ofrimin e burimeve financiare për vendet në nevojë.

**IPCC:** IPCC, ose Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, është një organ i Kombeve të Bashkuara që vlerëson njohuritë shkencore mbi ndryshimet klimatike. Ai ofron vlerësime të rregullta mbi bazën shkencore të ndryshimeve klimatike, ndikimet e tyre dhe masat e mundshme për adaptim dhe zbutje. IPCC u krijua në vitin 1988 nga Organizata Botërore Meteorologjike (ËMO) dhe Programi i



Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP). Qëllimi i tij është të informojë politikëbërësit dhe publikun mbi rreziqet dhe opsionet e lidhura me ndryshimet klimatike bazuar në prova shkencore.

**J**

**K**

**Karburant i Derivuar nga Mbetjet (KDM):** Karburanti i Derivuar nga Mbetjet (KDM) është një burim energjie i rinovueshëm i prodhuar nga komponentët e djegshëm të mbetjeve të ngurta. Këto mbetje, të marra nga vendet industriale ose tregtare, i nënshtrohen procesit të grimcimit, tharjes dhe paketimit përpara se të digjen për të gjeneruar energji elektrike. KDM ofron një alternativë miqësore me mjedisin ndaj depozitimit në landfill duke përdorur mbetjet për prodhimin e energjisë. Ai gjithashtu mund të përdoret si karburant në furrat e çimentos, duke zëvendësuar karburantet fosile konvencionale si qymyri, pasi të plotësojë kërkesat specifike. KDM mund të klasifikohet më tej në KDG (Karburante të Derivuara nga Gomat), KRN (Karburante të Rehabilituara të Ngurta) dhe AF (Karburante Alternative).

**Kodet e Performancës Energjetike:** Kodet e performancës energjetike janë rregullore dhe standarde që ndërtesat duhet të plotësojnë në lidhje me eficientësinë dhe konsumin e tyre energjetik. Këto kode përmbajnë kërkesa për aspekte të tilla si izolimi, sistemet HVAC, ndriçimi dhe integrimi i energjisë së rinovueshme. Qëllimi i tyre është të promovojnë praktika të qëndrueshme në ndërtim, të reduktojnë konsumin e energjisë dhe të ulin emetimet e gazeve serra.

**Komuniteti i Energjisë:** Komuniteti i Energjisë është një organizatë ndërkombëtare që nxit integrimin e Bashkimit Evropian (BE) dhe vendeve fqinje të tij në një treg të bashkuar pan-evropian të energjisë. I themeluar nga Traktati i nënshkruar në vitin 2005 në Athinë, Greqi, Komuniteti i Energjisë synon të zgjerojë rregullat dhe parimet e tregut të brendshëm të energjisë së BE-së në vendet e Evropës Juglindore, rajonin e Detit të Zi dhe më gjerë. Ky kuadër ligjor i detyrueshëm promovon bashkëpunimin, harmonizimin dhe adoptimin e politikave të përbashkëta energjetike për të rritur sigurinë energjetike, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik në vendet pjesëmarrëse.

**Koncepti i Komunikimit të Brendshëm:** Koncepti i Komunikimit të Brendshëm është një strategji që organizatat përdorin për të siguruar komunikim efektiv brenda ekipeve të tyre. Qëllimi i tij është të mbajë të gjithë anëtarët të informuar dhe të angazhuar me nismat për energjinë dhe klimën. Ky koncept ndihmon në krijimin e një ndjenje të unitetit dhe bashkëpunimit, duke çuar në zbatimin e suksesshëm të projekteve të lidhura me energjinë dhe klimën.

**Koncepti i Renovimit:** Koncepti i renovimit është një plan i krijuar për të përmirësuar ndërtesat në aspektin e eficientësisë së energjisë, komoditetit dhe qëndrueshmërisë. Ai përfshin rinovimin dhe bërjen e ndryshimeve të nevojshme për të rritur performancën e përgjithshme të ndërtesës. Qëllimi është të reduktohet konsumi i energjisë, të rriten nivelet e komoditetit dhe të promovohet qëndrueshmëria.

**Kompanitë e Shërbimeve të Energjisë (ESCOs):** ESCO-të, ose Kompanitë e Shërbimeve të Energjisë, janë kontraktorë të specializuar në retrofitimin energjetik. Ata financojnë kostot e retrofitimit duke përdorur kursimet e kostove të energjisë të arritura përmes masave të eficientësisë. ESCO-të përdorin metoda të ndryshme për të identifikojnë këto kursime nga klientët, duke i mundësuar atyre të ofrojnë zgjidhje për eficientësinë e energjisë pa kosto paraprake.

**Konsumi Final i Energjisë:** Konsumi Final i Energjisë i referohet sasisë totale të energjisë të përdorur nga përdoruesit fundorë si familjet, industrinë dhe bujqësia. Ai përfaqëson energjinë që arrin te konsumatori dhe përjashton energjinë e përdorur nga vetë sektori energjetik. Kjo përbën sasinë e energjisë së konsumuar drejtpërdrejt nga përdoruesit fundorë për qëllime të ndryshme.

**Konsumi i Energjisë Primare (KEP):** Konsumi i Energjisë Primare (KEP) i referohet energjisë që është drejtpërdrejt e disponueshme në burimin e saj përpara se të konvertohet. Kjo përfshin burime të ndryshme energjie si qymyri, linjiti, nafta e papërpunuar, gazi natyror, si dhe burimet e rinovueshme si energjia diellore, energjia e erës, hidroenergjia, energjia gjeotermale dhe energjia e baticave.

**Kontraktimi i Performancës Energjetike (KPE):** Kontraktimi i Performancës Energjetike (KPE) është një marrëveshje kontraktuale midis një përfituesi dhe një ofruesi të shërbimeve të përmirësimeve të eficientësisë së energjisë (kompanive ESCO). Ofruesi i KPE-së garanton arritjen e nivelit të dakordësuar të kursimeve të energjisë ose reduktimeve të lidhura me kostot dhe merr përsipër rreziqet e lidhura me zbatimin dhe operimin e masave. Investimet në masat e eficientësisë së energjisë paguhen bazuar në



nivelin e dakordësuar të përmirësimit ose kritere të tjera të performancës, si kursimet financiare të zbatimit.

**Kontraktimi i Furnizimit me Energji (KFE):** Kontraktimi i Furnizimit me Energji (KFE) është një kontratë për furnizimin eficient të energjisë. Ai matet dhe kontraktohet bazuar në sasinë e energjisë të dorëzuar në megavat-orë (MËh). KFE siguron një furnizim të besueshëm dhe eficient të energjisë për përfituesin. ESC shpesh përfshin përdorimin e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) ose të paktën karburante më pak karbon (p.sh. kalimi nga qymyri ose nafta e rëndë në gaz natyror).

**Kontribut Kombëtar i Përcaktuar (KKP):** KKP, ose Kontributi Kombëtar i Përcaktuar, është një plan veprimi për klimën i krijuar nga secili vend për të reduktuar emetimet e gazeve serrë dhe për t'u përshtatur ndaj ndikimeve klimatike. I kërkuar sipas Marrëveshjes së Parisit, vendet duhet të përditësojnë NDC-të e tyre çdo pesë vjet, duke përshkruar objektivat, politikat dhe masat e tyre për të luftuar ndryshimet klimatike.

**Konventa e Kryetarëve të Bashkive:** Konventa e Kryetarëve të Bashkive është një nismë e mbështetur nga Komisioni Evropian që bashkon mijëra njësi të qeverisjes lokale në vendet Evropiane dhe më gjerë, të angazhuara për krijimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për komunitetet e tyre. Duke u bashkuar me këtë nismë, njësitë e qeverisjes lokale zotohen vullnetarisht të zbatojnë objektivat klimatike dhe energjetike të vendosura nga Bashkimi Evropian. Përmes pjesëmarrjes së tyre, ato demonstronjë përkushtimin e tyre për të adresuar ndryshimet klimatike dhe për të promovuar energjinë e rinovueshme, duke kontribuar për një shoqëri më të gjelbër dhe më të qëndrueshme.

**Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC):** Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) është një marrëveshje ndërkombëtare e miratuar në vitin 1992. Ajo u nënshkrua nga mbi 150 vende dhe Komiteti Evropian në Samitin e Tokës në Rio de Janeiro. Qëllimi kryesor i konventës është stabilizimi i përqendrimeve të gazrave serrë në atmosferë për të parandaluar ndërhyrjet e dëmshme në sistemin klimatik. Të gjitha vendet pjesëmarrëse kanë angazhime në kuadër të konventës. Palët në konventë synojnë të reduktojnë emetimet e tyre të gazrave serrë në nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2000. UNFCCC hyri në fuqi në mars 1994. Ajo është gjithashtu e lidhur me Protokollin e Kiotos.

## L

**Llamba Fluorescente Kompakte (CFL):** Llambat CFL janë llamba që kursejnë energjinë që përdorin dhe kanë një kohëzgjatje më të madhe se llambat tradicionale inkandeshente, duke ofruar të njëjtën sasi drite. Ato janë një opsion më efikas dhe me kosto më të ulët për ndriçim, duke ndihmuar në kursimin e energjisë dhe reduktimin e faturave të energjisë elektrike.

**LED (diodë që lëshon dritë):** LED, ose diodë që lëshon dritë, është një teknologji ku materialet që prodhojnë dritë janë të mbështjella brenda një materiali të ngurtë. Kjo bën që llambat LED të zgjasin më shumë krahasuar me llambat që përdorin teknologji të tjera si inkandeshente apo fluoreshente. Ndryçimi LED është gjithashtu më i qëndrueshëm dhe më pak i prirur për të dëmtuar për shkak të goditjeve ose dridhjeve.

**LULUCF (Përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pylltaria):** LULUCF luan një rol në reduktimin e akumulimit të dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>) në atmosferë. Kjo është për shkak se CO<sub>2</sub> mund të ruhet si karbon në bimësi dhe tokë në ekosistemet tokësore. Sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, çdo proces që largon një gaz serrë nga atmosfera quhet "përthithës". Aktivitetet njerëzore, veçanërisht të lidhura me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës dhe pylltarinë, ndikojnë në këto përthithje tokësore. Si rezultat, ka ndryshime në shkëmbimin e CO<sub>2</sub> midis bimësisë së Tokës dhe atmosferës, gjë që ndikon në ciklin e karbonit.

## M

**Marrëveshja e Gjelbër:** Marrëveshja e Gjelbër, e prezantuar në vitin 2019 nga Komisioni Evropian, është një plan për ta bërë Bashkimin Evropian më të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj klimës deri në vitin 2050. Ajo është hartuar në Unionin e Energjisë dhe synon të reduktojë emetimet në të gjitha sektorët me të paktën 55% deri në vitin 2030. Marrëveshja e Gjelbër mbulon fusha të ndryshme dhe kërkon të transformojë BE-në në një ekonomi moderne, eficiente në përdorimin e burimeve dhe

konkurrese. Qëllimet e saj përfshijnë arritjen e zero emetimeve të gazeve serrë deri në vitin 2050, promovimin e rritjes ekonomike pa konsumuar shumë burime dhe sigurimin që të gjithë të përfitojnë nga këto ndryshime dhe që asnjë person apo vend të mos mbetet prapa.

**Marrëveshja e Parisit:** Marrëveshja e Parisit është një marrëveshje botërore për klimën e miratuar nga 196 palë në konferencën për klimën në Paris në dhjetor 2015. Ajo është marrëveshja e parë ligjërishit detyruese e këtij lloji dhe ka për qëllim të parandalojë ndryshimet e rrezikshme klimatike duke kufizuar ngrohjen globale nën 2 °C, me një synim për ta mbajtur atë në 1.5 °C. Marrëveshja gjithashtu fokusohet në përmirësimin e aftësisë së vendeve për të adresuar ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe në ofrimin e mbështetjes për përpjekjet e tyre. Ajo hyri në fuqi më 4 nëntor 2016.

**Matja e Zgjuar:** Matja e zgjuar i referohet teknologjive të avancuara të matjes që ofrojnë informacione të detajuara dhe në kohë reale rreth konsumit të energjisë. Këto matje lejojnë menaxhimin dhe faturimin më të mirë të energjisë duke siguruar të dhëna të sakta dhe të përditësuara mbi përdorimin e energjisë. Matja e zgjuar u mundëson konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të monitorojnë dhe optimizojnë konsumin e energjisë.

**Matja, Raportimi dhe Verifikimi (MRV):** Matja, Raportimi dhe Verifikimi (MRV) është një proces i përdorur për të matur dhe raportuar sasinë e emetimeve të gazeve serrë (GHG) të reduktuara përmes aktiviteteve specifike të zbutjes, si shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve. Ky proces përfshin ndjekjen e emetimeve gjatë një periudhe kohe dhe raportimin e gjetjeve të një palë e tretë e akredituar. Pala e tretë më pas verifikon raportin, duke certifikuar rezultatet dhe duke mundësuar lëshimin e krediteve të karbonit. MRV siguron transparencë dhe llogaridhënie në përpjekjet për reduktimin e emetimeve.

**Mbetje (jo të rinovueshme):** Mbetjet jo të rinovueshme i referohen materialeve që vijnë nga burime të ndryshme si industria, institucione të ndryshme, spitale dhe familjet. Këto materiale mund të jenë në formë të ngurtë ose të lëngshme dhe përfshijnë artikuj si gome, plastikë, vajra fosilë të mbeturinave dhe lloje të ngjashme mbetjesh. Ndryshe nga mbetjet e rinovueshme, mbetjet jo të rinovueshme nuk mund të rimbushen ose rigjenerohen natyrshëm.

**Mbështetja për Efiçencën Energjitike të NVM-ve në Industri:** Mbështetja për Efiçencën Energjitike të NVM-ve në industri përfshin programe dhe burime për bizneset e vogla dhe të mesme në sektorin industrial. Këto synojnë t'i ndihmojnë ato të bëjnë përmirësime në efiçencën e energjisë. Mbështetja mund të përfshijë udhëzime, financim dhe asistencë teknike. Duke zbatuar këto përmirësime, bizneset mund të reduktojnë konsumin e energjisë, të kursejnë para dhe të kontribuojnë në qëndrueshmërinë mjedisore.

**MECAP (Plani Lokal i Veprimit për Energjinë dhe Klimën):** MECAP është një dokument strategjik që udhëzon bashkitë në përmirësimin e efiçencës së energjisë dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë. Ai përshkruan veprime dhe nisma specifike për të arritur qëllimet e qëndrueshmërisë, duke përfshirë masa të tilla si ruajtja e energjisë, adoptimi i energjisë së rinovueshme, përmirësimet në transport dhe menaxhimi i mbetjeve. MECAP luan një rol thelbësor në krijimin e komuniteteve më të qëndrueshme dhe të adaptueshme ndaj klimës.

**MEMU (Njësia e Menaxhimit të Energjisë në Bashki):** MEMU, ose Njësia e Menaxhimit të Energjisë në bashki, është një organ brenda bashkisë që është përgjegjës për zbatimin e masave dhe politikave për energjinë dhe klimën. Kjo njësi është përgjegjëse për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë dhe koordinon zbatimin e MECAP.

**Menaxhimi i Kërkesës së Energjisë (MKE):** Menaxhimi i kërkesës së energjisë (MKE) i referohet strategjive që synojnë reduktimin e kërkesës maksimale për energji elektrike dhe optimizimin e konsumit të energjisë nga ana e konsumatorëve. Tradicionalisht, është përdorur për të ndihmuar shërbimet publike të shmangin nevojën për kapacitete shtesë duke ulur ngarkesën e përgjithshme të energjisë elektrike gjatë periudhave të pikut. Megjithatë, MKE ofron disa avantazhe shtesë. Duke reduktuar ngarkesën në rrjetin elektrik, ndihmon në parandalimin e emergjencave, minimizimin e ndërprerjeve të energjisë dhe përmirësimin e besueshmërisë së sistemit. Mund të zvogëlojë gjithashtu varësinë nga importet e kushtueshme të karburantit, të ulë çmimet e energjisë dhe të kontribuojë në qëndrueshmërinë mjedisore duke ulur emetimet e dëmshme. Për më tepër, MKE luan një rol të rëndësishëm në drejtimin e investimeve të mëdha në infrastrukturë për gjenerimin, transmetimin dhe shpërndarjen. Në përgjithësi, MKE sjell përfitime të dukshme ekonomike, besueshmëri dhe përfitime mjedisore kur zbatohet në sistemet e energjisë elektrike.





**Miqësor me Mjedisin:** Miqësor me mjedisin i referohet veprimeve që minimizojnë dëmtimin e mjedisit dhe priorizojnë qëndrueshmërinë. Duke miratuar praktika miqësore me mjedisin, individët dhe organizatat kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit, reduktimin e ndotjes dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Shembuj të veprimeve miqësore me mjedisin përfshijnë përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, praktikimin e riciklimit dhe reduktimit të mbetjeve, promovimin e zgjidhjeve të qëndrueshme të transportit dhe zgjedhjen e produkteve miqësore me mjedisin.

**Mobiliteti i Qëndrueshëm Urban:** Mobiliteti i qëndrueshëm urban promovon transportin miqësor me mjedisin dhe zhvillimin urban të qëndrueshëm. Ai fokusohet në përdorimin e metodave të transportit që kanë ndikim minimal mjedisor dhe në planifikimin e qyteteve me qëllime të qëndrueshmërisë në mendje.

**Modernizimi i Ndrçimit Publik:** Modernizimi i ndriçimit publik i referohet nismave që fokusohen në përmirësimin e efikasitetit energjetik të sistemeve të ndriçimit publik, si ndriçimi i rrugëve dhe hapësirave publike. Këto nisma synojnë të përditësojnë dhe optimizojnë infrastrukturën e ndriçimit për të reduktuar konsumin e energjisë, për të përmirësuar cilësinë e ndriçimit dhe për të minimizuar ndikimin mjedisor.

## N

**Ndërtesë me thujse Zero-Energi (NZEB):** Një Ndërtesë me thujse Zero-Energi (NZEB) është një ndërtesë që demonstroi një performancë të shumë të mirë energjetike. Kërkon një sasi minimale energjie, e cila buron kryesisht nga burime të rinovueshme, përfshirë gjenerimin e energjisë së rinovueshme në vend ose afër tij. Ky përkufizim është përshkruar në Direktivën 2010/31/BE, duke theksuar rëndësinë e efikasitetit të energjisë dhe energjisë së rinovueshme në ndërtimin dhe funksionimin e ndërtesave.

**Ndryshimet Klimatike:** Ndryshimet klimatike i referohen ndryshimeve afatgjata në sistemin klimatik të Tokës. Ato mund të identifikohen nga ndryshimet e modeleve mesatare të motit dhe variacionet që zgjasin për shumë vite apo edhe dekada. Bazat për identifikimin e këtyre modeleve dhe variacioneve janë p.sh. testet statistikore. Ndryshimet klimatike mund të ndodhin për shkak të proceseve natyrore ose faktorëve të jashtëm, por gjithashtu mund të shkaktohen nga aktivitetet njerëzore. Kur flasim për ndryshimet klimatike të shkaktuara nga njeriu (antropogjenike), i referohemi në mënyrë specifike rritjes së temperaturave globale të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore, si p.sh. liri i gazeve serrë si dioksidi i karbonit dhe metani në atmosferë. Këto gaze bllokohen nxehtësinë dhe kontribuojnë në ngrohjen e planetit. Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) bën dallimin midis ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore dhe variabilitetit natyror të klimës.

## O

**Objektivat për Klimën dhe Energjinë:** Objektivat për klimën dhe energjinë i referohen qëllimeve të vendosura nga shtetet ose bashkitë në përputhje me objektivat ndërkombëtare për të reduktuar emetimet e dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>), për të rritur efikasitetin energjetik dhe për të promovuar përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme (ER). Duke vendosur objektiva specifike, qeveritë dhe autoritetet lokale tregojnë përkushtimin e tyre për të adresuar ndryshimet klimatike, për të promovuar masat e efikasitetit energjetik dhe për të rritur pjesën që zë energjia e rinovueshme në totalin e energjisë së përdorur. Këto objektiva luajnë një rol thelbësor në vendimmarrjet politike dhe në nxitjen e veprimeve për të arritur qëllimet globale të qëndrueshmërisë.

**Optimizimi i Rrugëve të Mbledhjes së Mbetjeve:** Optimizimi i rrugëve të mbledhjes së mbetjeve përfshin planifikimin e rrugëve për mbledhjen e mbetjeve. Qëllimi është të gjenden rrugët më efikase për automjetet e mbledhjes së tyre për të minimizuar distancën dhe kohën e udhëtimit, duke çuar në kursime të kostove dhe përfitime mjedisore. Duke optimizuar rrugët e mbledhjes së mbetjeve, mund të përmirësohet efikasiteti i përgjithshëm i operacioneve të menaxhimit të mbetjeve, duke rezultuar në ulje të përdorimit të karburantit dhe reduktim të emetimeve të gazrave serrë.

## P

**Pajisje Efikase për Ujin:** Pajisjet efikase për ujin janë pajisje të ndërtuara posaçërisht për të ndihmuar në reduktimin e konsumit të ujit. Shembuj përfshijnë rubinetat dhe tualetet me rrjedhje të ulët. Këto pajisje promovojnë ruajtjen e ujit duke përdorur më pak ujë pa dëmton funksionalitetin.

**Paketa për Energji të Pastër:** Miratimi i Paketës për Energji të Pastër në vitin 2019 shënon një hap të rëndësishëm drejt transformimit të kuadrit të politikës energjetike evropiane. Qëllimi i saj kryesor është të lehtësojë kalimin nga karburantet fosile tek burimet e energjisë më të pastra dhe më të qëndrueshme. Vendimi 2022/02/MC-EnC, i miratuar nga Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë më 15 Dhjetor 2022, përcakton objektivat energjetike dhe klimatike për vitin 2030. Këto objektiva janë thelbësore për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë për të përparuar drejt arritjes së neutralitetit klimatik deri në vitin 2050 dhe për të reduktuar varësinë e tyre nga karburantet fosile në të ardhmen e afërt.

Për Shqipërinë, objektivat deri në vitin 2030 janë si më poshtë:

- **\*\*Emetimet e gazeve serrë\*\*:** Një ulje prej 53.2% nën nivelet e regjistruara në vitin 1990.
- **\*\*Energjia e rinovueshme\*\*:** Arritja e një përqindjeje prej 52.0% të energjisë nga burimet e rinovueshme.
- **\*\*Efiçenca energjetike\*\*:** Konsumi primar i energjisë duhet të jetë 2.60 milion ton naftë ekuivalente (Mtoe), dhe konsumi final i energjisë duhet të jetë 2.40 Mtoe.

Këto objektiva pasqyrojnë angazhimin e Shqipërisë për të kaluar në një sistem energjie më të qëndrueshëm dhe më të pastër.

**Parko dhe udhëto:** Parko dhe udhëto i referohet stacioneve të transportit publik ku udhëtarët mund të parkojnë automjetet e tyre personale dhe të kalojnë në autobusë, trena ose të ndajnë me të tjerët automjete për pjesën tjetër të udhëtimit të tyre drejt qendrave të qytetit. Automjetet mbahen në parking gjatë ditës dhe merren përsëri kur udhëtari kthehet. Këto objekte janë zakonisht të vendosura në zonat periferike ose të jashtme të qyteteve të mëdha, duke ofruar një opsion të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të transportit që redukton ngarkesën e trafikut dhe inkurajon përdorimin e transportit publik.

**Performanca energjetike e një ndërtese:** Performanca energjetike e një ndërtese mat efikasitetin e energjisë të kësaj ndërtese në terma të energjisë së nevojshme për ndriçim dhe ngrohje. Ajo ofron njohuri mbi sa me efektivitet një ndërtesë shfrytëzon burimet energjetike. Vlerësimi i performancës energjetike ndihmon në identifikimin e zonave për përmirësim, zbatimin e masave të kursimit të energjisë dhe reduktimin e kostove operative. Qëllimi është kemi një efikasitet të energjisë në ndërtesë, duke minimizuar ndikimin mjedisor.

**Përgatitja për Investime:** Përgatitja për investime përfshin aktivitete të ndryshme për t'u përgatitur për investime të rëndësishme në infrastrukturë ose teknologji. Këto aktivitete përfshijnë kryerjen e studimeve të fizibilitetit, zhvillimin e projekteve të detajuara inxhinierike dhe krijimin e dokumenteve të tenderit. Këto përgatitje i ndihmojnë institucionet dhe organizatat të marrin vendime të informuara dhe të sigurojnë një proces të qetë zbatimi për investimet e tyre.

**Pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumimin e energjisë:** Pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumimin e energjisë i referohet përqindjes së energjisë së marrë nga burime të rinovueshme në totalin e energjisë së përdorur në fazat përfundimtare të konsumimit. Ajo tregon përqindjen e konsumimit të energjisë që vjen nga burime të rinovueshme.

**Planifikimi Hapësinor i Energjisë:** Planifikimi hapësinor i energjisë përfshin integrimin e energjisë në planifikimin hapësinor. Ai fokusohet në shpërndarjen dhe optimizimin e burimeve të energjisë. Një plan hapësinor për ngrohje/ftohje është një dokument strategjik që përshkruan mënyrën se si një bashki menaxhon nevojat për ngrohje dhe ftohje brenda zonës së saj. Plani thekson efikasitetin e energjisë dhe integrimin e burimeve të rinovueshme të energjisë për të përmbushur kërkesat për ngrohje dhe freskim.

**Plani i Menaxhimit të Mbetjeve:** Plani i Menaxhimit të Mbetjeve është një strategji gjithëpërfshirëse që trajton aspekte të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve, si mbledhja, ndarja, riciklimi dhe kompostimi. Qëllimi i planit është të minimizojë mbetjet dhe të promovojë një ekonomi rrethore, ku burimet ripërdoren dhe riciklohen në vend që të hidhen.

**Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU):** Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) është një plan strategjik që synon të plotësojë nevojat e transportit të banorëve dhe bizneseve në qytete dhe zonat përreth tyre. Qëllimi i tij është të përmirësojë cilësinë e jetës duke krijuar një sistem transporti të qëndrueshëm. Një plan i tillë ndërtohet mbi praktikatat ekzistuese të planifikimit dhe përfshin parimet e integritimit, pjesëmarrjes dhe vlerësimit për të siguruar një zbatim efektiv.

**Plani i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën (SECAP):** Plani i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën (SECAP) është një dokument strategjik i përgatitur dhe zbatuar nga nënshkruesit e Paktit të Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energjinë. SECAP trajton si zbatimin ashtu edhe përshtatjen ndaj klimës me një afat kohor deri në vitin 2030. Ai përshkruan mënyrën se si nënshkruesit do të arrijnë vizionin dhe objektivat e tyre.

**Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK):** PKEK është një dokument strategjik që përshkruan se si vendet e Bashkimit Evropian (BE) planifikojnë të arrijnë objektivat për energjinë dhe klimën të përcaktuara për vitin 2030. Këto plane u prezantuan si pjesë e paketës "Energji e Pastër për të Gjithë Evropianët" dhe mbulojnë fusha të tilla si efienca e energjisë, energjia e rinovueshme, reduktimi i emetimeve të gazeve serrë, kërkimi dhe inovacioni. PKEK kërkon koordinim ndërmjet departamenteve qeveritare dhe ofron një kornizë për investimet publike dhe private në përputhje me objektivat e energjisë dhe klimës së BE-së.

**Prodhimi i Peletëve të Drurit:** Prodhimi i peletëve të drurit i referohet procesit të prodhimit të burimeve të qëndrueshme të karburantit nga tallashi i kompaktuar ose materiale të tjera biomase. Këto burime karburanti, të njohura si peletë druri, përdoren në sistemet e ngrohjes. Procesi i prodhimit përfshin kompresimin e materialit të biomasës për të formuar peletë të vegjël, të cilët mund të digjen në mënyrë efikase për gjenerimin e nxehtësisë.

**Programi i Ndërrimit të boilerëve:** Programi i ndërrimit të boilerëve është një nismë që synon të zëvendësojë kazanët e vjetëruar dhe joefikas në ndërtesa me modele moderne dhe eficientë në energji. Objektivi i këtyre programeve është të reduktojë konsumin e energjisë dhe emetimeve duke promovuar përdorimin e sistemeve të ngrohjes më efikase. Një kazan me efienca energjike ndihmon në përmirësimin e qëndrueshmërisë, uljen e kostove të energjisë dhe kontribuon në mbrojtjen e mjedisit. Nëse këto programe janë të disponueshme në vendin tuaj të banimit ju mund të informoheni përmes burimeve të informacionit në bashki, kompanive të shërbimeve publike ose Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

**Prokurimi i Gjelbër:** Prokurimi i gjelbër përkufizohet nga Komisioni Evropian kur autoritetet publike zgjedhin të blejnë mallra, shërbime dhe punë që kanë një ndikim më të vogël mjedisor gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës krahasuar me alternativat me të njëjtin qëllim. Është një proces që synon të prioritetizojë opsionet miqësore ndaj mjedisit kur merren vendime për prokurim. Qëllimi është të reduktohet ndikimi i përgjithshëm mjedisor i blerjeve qeveritare dhe të promovohet qëndrueshmëria.

**Promovimi i Menaxhimit të Kërkesës së Energjisë:** Iniciativat për promovimin e menaxhimit të kërkesës së energjisë kanë për qëllim të inkurajojnë konsumatorët dhe bizneset të modifikojnë modelet e tyre të përdorimit të energjisë, duke reduktuar si kërkesën maksimale ashtu edhe konsumin e përgjithshëm të energjisë. Kjo mund të përfshijë masa të tilla si stimuj për pajisje me efienca energjike, çmime të bazuara në kohën e përdorimit dhe promovimin e praktikave për kursimin e energjisë. Qëllimi është të fuqizohen individët dhe organizatat për të bërë zgjedhje të vetëdijshme që kontribuojnë në një përdorim më të qëndrueshëm dhe eficient të energjisë.

**Promovimi i Transportit Jo-Motorik:** Promovimi i transportit jo-motorik inkurajon ecjen, çiklizmin dhe mënyra të tjera të transportit që përdoren nga njeriu si alternativa të qëndrueshme ndaj automjeteve motorike. Ky transport përfshin krijimin e infrastrukturës, politikave dhe fushatave të ndërgjegjësimit për ta bërë transportin jo-motorik më të sigurt dhe më të aksesueshëm. Këto përpjekje reduktojnë ngarkesën e trafikut, përmirësojnë cilësinë e ajrit dhe promovojnë mënyra jetese më të shëndetshme.

**Prosumator:** Një prosumator është një individ ose entitet që vepron si prodhues dhe konsumator i energjisë. Prosumatorët luajnë një rol të rëndësishëm në tranzicionin energjetik duke reduktuar në mënyrë aktive konsumin e tyre të energjisë dhe duke gjeneruar energji të rinovueshme.

**Punët e Gjelbërta:** Punët e gjelbra janë punët që ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe luftimin e ndryshimeve klimatike. Këto punë mund të jenë në industri që prodhojnë produkte të gjelbra, si energjia



e rinovueshme, ose në procese që janë miqësore ndaj mjedisit, si riciklimi. Punët e gjelbra luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe adresimin e sfidave mjedisore.

**Pyllëzimi:** Pyllëzimi i referohet procesit të krijimit të pyjeve të reja duke mbjellë pemë në zona që kanë qenë për një kohë të gjatë pa pyje ose që kurrë nuk kanë qenë të pyllëzuara më parë.

## Q

**Qytetet Rezistente:** Qytetet rezistente janë qytete që mund të përballojnë, të rikuperohen dhe të përgatiten për të ardhmen, si sfidat ekonomike, mjedisore, sociale dhe institucionale. Qytetet rezistente priorizojnë zhvillimin e qëndrueshëm, mirëqenien dhe rritjen gjithëpërfshirëse. Katër fusha kryesore që kontribuojnë në rezistencën e qyteteve janë: ekonomia, qeverisja, shoqëria dhe mjedisi. Duke u fokusuar në këto aspekte, qytetet rezistente mund të përshtaten më mirë, të begatojnë dhe të sigurojnë mirëqenien afatgjatë të komuniteteve të tyre.

## R

**Riciklimi:** Riciklimi është një proces ku materialet e mbetjeve transformohen në produkte, materiale të reja. Ky proces përfshin ripërpunimin e materialeve organike. Sidoqoftë, riciklimi nuk përfshin rikuperimin e energjisë ose ripërpunimin e materialeve në karburante apo kthim në gjendjen fillestare.

**Rikonstruksioni me efikasitet energjiek (EE):** Rikonstruksioni me efikasitet energjiek përfshin rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese për të përmirësuar performancën energjetike dhe për të reduktuar konsumin. Kjo zakonisht përfshin përmirësime të izolimit të godinës, përmirësimet e sistemeve HVAC (Ngrohje, Ventilim dhe Kondicionim Ajri) dhe zëvendësimin e pajisjeve. Qëllimi është të bëhet ndërtesa më efikase në energji, të ulen kostot operative dhe të përmirësohet komoditeti i banorëve.

**Ri-Pyillëzimi:** Ri-Pyillëzimi i referohet procesit të mbjelljes së pemëve në zona ku pyjet janë dëmtuar. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme si zjarret, thatësitat, sëmundjet ose aktivitetet njerëzore si pastrimi i tokës për bujqësi. Qëllimi i pyillëzimit është të rikthejë pemët dhe të promovojë rritjen e pyjeve të reja.

## S

**Sistemi i Menaxhimit të Energjisë:** Një sistem menaxhimi të energjisë (SME) është një kornizë për konsumatorët e energjisë, përfshirë industrinë, tregtinë dhe sektorin publik, për të menaxhuar përdorimin e tyre të energjisë. Ai ndihmon kompanitë të identifikojnë mundësitë për të adoptuar dhe përmirësuar teknologjitë e kursimit të energjisë, përfshirë ato që nuk kërkojnë domosdoshmërisht investime të larta kapitale. Në shumicën e rasteve, zbatimi i suksesshëm i një SME kërkon ekspertizë të specializuar dhe trajnimin e stafit. Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO), një sistem menaxhimi të energjisë përfshin zhvillimin dhe zbatimin e një politike të energjisë, vendosjen e objektivave të arritshme për përdorimin e energjisë, dhe hartimin e planeve të veprimit për t'i arritur ato dhe për të matur përparimin. Kjo mund të përfshijë zbatimin e teknologjive të reja efikase në energji, reduktimin e mbetjeve ose përmirësimin e proceseve aktuale për të ulur kostot e energjisë. Objektivat e zbatimit të këtij sistemi përfshijnë ruajtjen e burimeve, mbrojtjen e klimës dhe uljen e kostove, duke siguruar njëkohësisht qasje të vazhdueshme në energjinë e nevojshme. Duke zbatuar një sistem të tillë, përdoruesit mund të menaxhojnë në mënyrë efektive burimet e energjisë, të optimizojnë përdorimin dhe të arrijnë qëllimin e qëndrueshmërisë.

**Skenari:** Skenari i referohet një përshkrimi të thjeshtuar të mënyrës se si mund të zhvillohet e ardhmja, bazuar në një grup supozimesh për forcat drejtuese dhe marrëdhëniet kyçe. Këto supozime janë të qëndrueshme dhe koherente. Skenarët mund të dalin nga projeksionet dhe mund të përfshijnë informacione shtesë nga burime të tjera. Ata shpesh shoqërohen me një tregim narrativ. Skenarët klimatikë dhe skenarët e emetimeve janë lloje specifike të skenarëve të lidhura me ndryshimet klimatike.



**Skenarët Bazë:** Skenarët bazë, të njohur gjithashtu si skenarë reference, pika referimi, ose skenarë pa ndërhyrje, përfaqësojnë një projektion të së ardhmes së shoqërisë dhe mjedisit pa zbatimin e politikave të reja mjedisore dhe klimatike përtej atyre që janë planifikuar ose që janë në progres. Këta skenarë supozojnë se politikat ekzistuese kanë pak ose aspak ndikim në çështjet specifike që analizohen. Skenarët bazë shërbejnë si një pikë referimi për vlerësimin e efekteve dhe përfitimeve të mundshme të politikave dhe ndërhyrjeve të reja mjedisore.

**Sistemi Fotovoltaik Diellor (PV):** Një sistem fotovoltaik diellor (PV) është një sistem energjie që shfrytëzon dritën e diellit duke përdorur qeliza fotovoltaike për ta konvertuar drejtpërdrejt në energji elektrike të përdorshme. Këto sisteme janë të dizajnuara për të gjeneruar energji diellore duke marrë energjinë nga dielli. Duke përdorur qeliza fotovoltaike, sistemet PV diellore ofrojnë një burim të rinovueshëm dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike.

**Strategjia e Komunikimit dhe Plani i Veprimit:** Strategjia e komunikimit dhe plani i veprimit është një dokument strategjik që përshkruan mënyrën se si të komunikohen në mënyrë efektive temat e lidhura me energjinë dhe klimën te palët e ndryshme të interesit. Ky dokument përmban objektivat, mjetet dhe veprimet për të përfshirë dhe informuar audiencat e synuara.

## T

**Ton të barasvlershme me naftën (toe):** Një ton i barasvlershme me naftën (toe) është një njësi standarde e përdorur për të matur energjinë. Ajo përfaqëson sasinë e energjisë që mund të merret nga afërsisht një ton naftë bruto. I caktohet një vlerë kalorifike neto prej 41,868 kiloxhaul për kilogram. Njësia toe mundëson krahasimin e energjisë nga burime të ndryshme, duke lejuar një matje të standardizuar të energjisë nëpër sektorë të ndryshëm.

**Transporti Jo-Motorik:** Transporti jo-motorik përfshin mënyra të ndryshme të transportit të përdorura nga njeriu, duke përfshirë ecjen, çiklizmin dhe mjetet e vogla me rrota si biçikletat, skateboard-et, skuterët me shtytje, karrocet për persona me aftësi të kufizuara dhe karroca të tjera me tërheqje. Ky përshkrim fokusohet kryesisht te dy nga mënyrat kryesore jo-motorike: ecja dhe çiklizmi për qëllime transporti. Këto mënyra aktive të transportit promovojnë aktivitetin fizik, reduktojnë ngarkesën e trafikut dhe kontribuojnë në një lëvizshmëri urbane të qëndrueshme dhe të shëndetshme.

**Tranzicioni i Drejtë:** Në kontekstin e ndryshimeve klimatike, kalimi në një ekonomi me pak karbon ose me zero neto kërkon ndryshime të rëndësishme në sistemet tona ekonomike. Megjithatë, ky transformim mund të përkeqësojë pabarazinë sociale, përjashtimin social dhe të sjellë trazira, si dhe të dëmtojë bizneset dhe tregjet. Për ta adresuar këtë, është thelbësore që vendet të prioritojnë një tranzicion të drejtë. Kjo do të thotë të sigurohet që të gjitha komunitetet, punëtorët dhe grupet sociale të përfshihen dhe të përfitojnë nga ndryshimet strukturore që ndodhin. Një tranzicion i drejtë përfshin konsiderimin e ndikimit të tranzicioni mbi grupe të ndryshme sociale në të gjithë ekonominë dhe ofrimin e mundësive për trajnim dhe rikualifikim për të mbështetur punë të denja dhe për të shmangur lënien pas të askujt.

## U

**Udhëzime për Sjellje Ekologjike:** Udhëzimet për sjellje ekologjike ofrojnë rekomandime për praktika miqësore me mjedisin në aktivitetet e përditshme, duke promovuar qëndrueshmërinë dhe kursimin e energjisë. Ato synojnë të rritin ndërgjegjësimin për ndikimin mjedisor të veprimeve tona dhe të fuqizojnë individët që të bëjnë zgjedhje të informuara që reduktojnë gjurmën ekologjike. Duke ndjekur udhëzimet për sjellje ekologjike, individët dhe institucionet kontribuojnë për një të ardhme më të qëndrueshme duke ruajtur burimet, minimizuar mbetjet dhe duke promovuar praktika miqësore me mjedisin në jetën e përditshme.

## V

**Varfëria Energjetike:** Varfëria energjetike i referohet një situatë ku njerëzit nuk kanë qasje në shërbime bazë energjetike si ngrohja, ftohja, ndriçimi dhe fuqia. Ajo shpesh shkaktohet nga të ardhura të ulëta, kostot e larta të energjisë dhe ndërtesat ose pajisjet jo-eficente që konsumojnë shumë energji. Për të adresuar varfërinë energjetike, Shtetet Anëtare të BE-së janë të detyruara të përfshijnë masa në



Strategjitë Kombëtare Afatgjata të Rinovimit dhe Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës. Këto politika synojnë të lehtësojnë varfërinë energjetike duke përmirësuar efikasitetin e energjisë, duke ulur kostot e energjisë dhe siguruar qasje në shërbime bazë të energjisë për të gjithë.

X

Y

Z

**Zbulimi i Rrjedhjeve Aktive:** Ndërmarrja e një qasjeje proaktive për të gjetur dhe riparuar rrjedhjet në sistemet e ujit dhe energjisë. Kjo ndihmon në parandalimin e humbjeve dhe bën që sistemet të jenë më efikase.

**Zbutja:** Zbutja e ndryshimeve klimatike i referohet veprimeve të ndërmarra nga qeveritë, bizneset ose individët për të reduktuar emetimet e gazeve serrë ose për të përmirësuar përthithësitë e karbonit. Kjo mund të arrihet përmes adoptimit të energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë, bujqësisë së qëndrueshme dhe ndryshimeve në modelet e prodhimit dhe konsumit. Përmirësimi i përthithësve të karbonit përfshin restaurimin e ekosistemeve dhe ruajtjen e shëndetit të tokës. Zbutja e suksesshme kërkon mjedise mbështetëse me legjislacion, politika dhe investime. Për të kufizuar ngrohjen globale në 1.5°C, veprimet e zbutjes duhet të reduktojnë emetimet me 45% para vitit 2030 dhe të arrijnë emetime neto zero deri në mes të shekullit, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Parisit.

**Zero Mbetje:** Zero Mbetje i referohet qasjes dhe menaxhimit të produkteve dhe proceseve në mënyrë që të minimizohet mbetjet dhe të maksimizohet ruajtja e burimeve. Qëllimi është të devijohet 90 përqind ose më shumë mbetje nga landfillet apo djegësit. Duke arritur me sukses një qëllim Zero Mbetje, shkarkimet e dëmshme në tokë, ujë ose ajër, të cilat mund të paraqesin kërcënime për mjedisin dhe shëndetin, eliminohen të paktën 90 përqind. Kjo qasje synon të mbrojë planetin dhe të gjitha qëniet e gjalla duke minimizuar gjenerimin e mbeturinave dhe promovuar rikuperimin e burimeve.

**Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë:** Zgjidhjet e bazuara në natyrë janë qasje që trajtojnë sfidat shoqërore duke mbrojtur, menaxhuar dhe rikthyer ekosistemet në një mënyrë të qëndrueshme. Këto zgjidhje përfitojnë si njerëzit ashtu edhe natyrën duke adresuar çështje të tilla si ndryshimet klimatike, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, sigurinë ushqimore dhe ujore, humbjen e biodiversitetit dhe shëndetin e njeriut. Zgjidhjet e bazuara në natyrë luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe sigurojnë një marrëdhënie harmonike midis aktiviteteve njerëzore dhe mjedisit natyror.

ZH

**Zhvillimi i Korsive të Biçikletave:** Zhvillimi i korsive të biçikletave i referohet krijimit të rrugëve ose korsive të dedikuara posaçërisht për çiklistët. Këto korsitë të dedikuara synojnë të inkurajojnë përdorimin e biçikletave si një mënyrë e qëndrueshme dhe e shëndetshme e transportit, duke reduktuar varësinë nga mjetet motorike.

**Zhvillimi i qëndrueshëm:** Zhvillimi i qëndrueshëm i referohet një forme të rritjes ekonomike dhe progresit social që mund të ruhet me kalimin e kohës, duke përfituar jo vetëm brezin aktual, por edhe brezat e ardhshëm. Ai përfshin balancimin e zhvillimit ekonomik me mbrojtjen e mjedisit dhe drejtësinë sociale. Qëllimi është të plotësohen nevojat aktuale pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.



## Burimet (Maj 2024)

Më poshtë, do të gjeni një listë të faqeve të internetit që janë përdorur si burime në përpilimin e përkufizimeve për këtë fjalorth. Këto burime janë përzgjedhur me kujdes për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të dhënë. Ne i vlerësojmë kontributet e vlefshme të këtyre burimeve dhe inkurajojmë lexuesit t'i eksplorojnë ato më tej për një kuptim më të thellë të koncepteve të ndryshimeve klimatike dhe të energjisë së qëndrueshme.

<https://alliancejusttransition.eu/>

[https://archive.ipcc.ch/pdf/special-reports/srren/SRREN\\_Annex\\_Glossary.pdf](https://archive.ipcc.ch/pdf/special-reports/srren/SRREN_Annex_Glossary.pdf)

[https://cdm.unfccc.int/Reference/Guidclarif/glos\\_CDM.pdf](https://cdm.unfccc.int/Reference/Guidclarif/glos_CDM.pdf)

[https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Category:Energy\\_glossary](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Category:Energy_glossary)

[https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Glossary:Greenhouse\\_gas\\_\(GHG\)](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Glossary:Greenhouse_gas_(GHG))

<https://encyclopedia.pub/entry/27611>

[https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-strategy/national-energy-and-climate-plans-necps\\_en](https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-strategy/national-energy-and-climate-plans-necps_en)

<https://eu-mayors.ec.europa.eu/en/about>

<https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/circular-economy.html>

<https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/citizens-initiative.html>

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02010L0031-20210101>

[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:paris\\_agreement](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:paris_agreement)

[https://link.springer.com/referenceworkentry/10.1007/978-3-319-71061-7\\_1-1](https://link.springer.com/referenceworkentry/10.1007/978-3-319-71061-7_1-1)

<https://qualitee.eu/the-project/ees-definitions/>

<https://unfccc.int/topics/land-use/workstreams/land-use--land-use-change-and-forestry-lulucf>

<https://www.architecturaldigest.com/story/go-green-glossary>

<https://www.bmwk-energiewende.de/EWD/Redaktion/EN/Newsletter/2015/15/Meldung/direkt-answers-primary-energy.html>

[https://www.bpie.eu/wp-content/uploads/2021/09/Glossary-of-terms%E2%80%93Energy-efficiency-and-building-policies-in-the-EU\\_rev3.pdf](https://www.bpie.eu/wp-content/uploads/2021/09/Glossary-of-terms%E2%80%93Energy-efficiency-and-building-policies-in-the-EU_rev3.pdf)

<https://www.broadgroup.com/news/rdf-refuse-derived-fuel-explained>

<https://www.bulbs.com/learning/led.aspx>

<https://www.com-east.eu/en/glossary/>

[https://www.eea.europa.eu/help/glossary/eea-glossary/baseline-scenario#:~:text=Baseline%20scenarios%20\(also%20known%20as,not%20have%20a%20discernable%20influence](https://www.eea.europa.eu/help/glossary/eea-glossary/baseline-scenario#:~:text=Baseline%20scenarios%20(also%20known%20as,not%20have%20a%20discernable%20influence)

<https://www.enelgreenpower.com/learning-hub/gigawhat/search-articles/articles/2023/03/prosumers-energy>

<https://www.energy-community.org/aboutus/whoweare.html>

<https://www.energy-community.org/implementation/package/CEP.html>

<https://www.energysolutionsoxfordshire.org/energy-efficiency-a-glossary-of-terms/>

<https://www.energystar.gov/saveathome/improvements/how-it-works/glossary>

<https://www.epa.gov/agstar/how-does-anaerobic-digestion-work>

<https://www.european-energy-award.org/>

<https://www.european-energy-award.org/how-it-works/methodology/>



<https://www.financial-dictionary.info/terms/international-financial-institutions-ifi/>

<https://www.greenfacts.org/glossary/abc/afforestation.htm>

<https://www.greenfacts.org/glossary/abc/compact-fluorescent-lamps-cfls.htm>

<https://www.intechopen.com/chapters/45176>

<https://www.ipcc.ch/about/>

<https://www.ipcc.ch/site/assets/uploads/2018/03/wg2TARannexB.pdf>

<https://www.iucn.org/our-work/nature-based-solutions>

<https://www.knx.org/knx-en/newsroom/news/news/20240201-energy-management-a-glossary-of-terms/>

[https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/gov\\_glance-2011-49-en.pdf?expires=1710426155&id=id&accname=guest&checksum=51C1A8B49B3397B5B95AFAF3525003B3](https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/gov_glance-2011-49-en.pdf?expires=1710426155&id=id&accname=guest&checksum=51C1A8B49B3397B5B95AFAF3525003B3)

<https://www.oecd.org/cfe/resilient-cities.htm>

<https://www.rcc.int/greenagenda>

<https://www.rubicon.com/blog/rubicon-waste-terminology/>

<https://www.un.org/en/climatechange/all-about-ndcs>

<https://www.undp.org/publications/climate-dictionary>

<https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-10/undp-the-climate-dictionary-v3.pdf>

[https://www.unido.org/sites/default/files/2009-02/Module14\\_0.pdf](https://www.unido.org/sites/default/files/2009-02/Module14_0.pdf)

<https://www.urbanmobilityportal.com/glossary>

<https://www.worldbank.org/en/news/feature/2022/07/27/what-you-need-to-know-about-the-measurement-reporting-and-verification-mrv-of-carbon-credits>

<https://alliancejusttransition.eu/>

<https://alliancejusttransition.eu/>